

EC

MA NDRYSHE

ANALIZA MJEDISORE E RAJONIT TË PRIZRENIT

Botues: EC Ma Ndryshe

Rr: Fehmi Lladrovci 94, 20000 Prizren

Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr.5, 1000 Prishtinë, Kosovë

www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org

+381 29 222 771 & +381 38 224 967

Ky publikim u realizua nga EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit “Monitoruesi Mjedisor” me mbështetje finaciare të Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS).



1	HYRJE
3	KORNIZA LIGJORE, STRATEGJITË DHE PLANET MJEDISORE
8	FORCAT SHTYTËSE DHE PRESIONET NË MJEDIS
11	FUSHËVEPRIMET ME INTERES NË MBROJTJE TË MJEDISIT
14	GJENDJA E MJEDISIT NË KOMUNAT E RAJONIT TË PRIZRENIT
27	PROBLEMET KYÇE DHE REKOMANDIMET
31	EC MA NDRY SHE

Mjedisi dhe sfidat me të cilat përballet ai janë vënë në fokus të politikave lokale dhe qendrore në mbarë botën. Kjo për faktin se mjedisi ndër të tjera determinon cilësinë e jetës së qytetarëve dhe mirëqenien e tyre, duke ndikuar thellësisht në gjendjen shëndetësore të tyre. Mjedisi në fakt luan rol të madh në shëndetin mendor, fizik dhe në aspektin social të secilit qytetar.

Riciklimi, përdorimi minimal i plastikës dhe lëndëve djegëse, kursimi i energjisë dhe burimet e saj janë disa nga çështjet me interes sa i përket një mjedisi të shëndetshëm. Përqëndrimi i politikave nacionale me fokus në këto dhe çështje të tjera me interes për mbrojtjen e mjedisit, jo vetëm do të mund të përmirësonin kualitetin jetësor të qytetarëve, por do të hapnin mundësi për zhvillim ekonomik, bujqësor e turistik të një vendi.

Vetëm në 30 vitet e fundit, Bashkimi Evropian ka ndërmarrë masa të konsiderueshme me qëllim të përmirësimit të cilësisë së mjedisit për qytetarët evropian dhe sigurimin e një cilësie më të lartë jetësore për ta. Për më tepër, këto masa janë kushtëzuar që të pranohen nga vendet anëtare të BE me qëllim të ruajtjes së pakontestueshme të së ashtuquajturës 'shtëpi e përbashkët'.¹

Komisioni Botëror për Mjedis dhe Zhvillim i emëruar për të përkufizuar 'Agjendën Globale për Ndryshim', kishte vënë në pah rëndësinë e përfshirjes së politikave qendrore me qëllim të ruajtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Vetëm përmes menaxhimit të resurseve ekzistuese, mund të sigurohet mbijetesa e jetës në tokë dhe zhvillimi i qëndrueshëm. Sigurimi i jetëgjatësisë së burimeve mjedisore ekzistuese përbën një temë aktuale të të gjitha kohërave, meqenëse varësisht nga përmbushja e kësaj objektive ose jo, kushtëzohet mirëqenia e gjeneratave që vijnë.²

Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2019³, përmes të cilit instrument Komisioni Evropian e mat progresin e vendit tonë në përmbushjen e agjendës evropiane brenda vitit kalendarik, cilëson se Kosova është ende në një fazë të hershme sa i përket përgatitjes së saj për tu përballur me çështjen e mbrojtjes së mjedisit dhe ndryshimeve klimatike. Ky raport vlerëson se është arritur progres sa i përket draftimit të strategjive në këtë fushëveprim, mirëpo problemet mjedisore vazhdojnë ta vënë në rrezik jetesën dhe shëndetin e popullsisë. Për ta ndryshuar këtë situatë rekomandohet që gjatë vitit që vie, Kosova të angazhohet në këto çështje kryesore: (1) Të vendosë sistem efektiv të monitorimit të cilësisë së ujit, të publikojë të dhëna dhe të ndërmarrë masa urgjente për të zvogëluar ndotjen e ajrit dhe ujit; (2) Të vazhdojë të rrisë mbulueshmërinë e grumbullimit të mbeturinave nga ekonomitë familjare dhe të adresojë çështjen e deponive të paligjshme; (3) Të zbatoj dispozitat ligjore për përgjegjësinë, dëmtimet dhe krimin mjedisor; të zbatojë parimin ndotësi paguan dhe të ngrejë vetëdijen publike për mbrojtjen e mjedisit; (4) Të zbatojë strategjinë për ndryshimet klimatike dhe planin e veprimit për ndryshimet klimatike, të përgatisë një udhëzues për harmonizimin me *acquis-in* për klimën dhe të fillojë punën për planin e energjisë dhe klimës në përputhje me rekomandimet e Komunitetit të Energjisë.⁴

¹ https://ec.europa.eu/environment/legal/implementation_en.htm

² <https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/5987our-common-future.pdf>

³ <https://www.mei-ks.net/sq/raporti-i-progresit-585>

⁴ Ibid.

Për përmbushjen e këtyre parashikimeve mjedisore, pritshmëritë janë për një angazhim më të madh si në nivelin qendror, poashtu edhe atë lokal. Sidoqoftë, të dhënat nga terreni në nivel komunal flasin për një realitet tjetër sa i përket prioritizimit të çështjes së mjedisit. Konkretisht komunat e rajonit të Prizrenit, përfshirë këtu Prizrenin, Suharekën, Malishevën, Rahovecin, Dragashin dhe Mamushën kanë raportuar për një rënie të investimeve të parashikuara gjatë vitit 2020 për mbrojtjen e mjedisit, apo në rastin më pak të keq, për një ruajtje të vlerës investive të vitit 2019 edhe përgjatë vitit 2020.⁵

Komuna e Prizrenit raporton ta ketë patur vlerën buxhetore për mbrojtjen e mjedisit për vitin 2019 në vlerë prej 2,5 milionë euro, vlerë kjo e cila është paraparë të mbetet e njëjtë edhe për vitin 2020. Komuna e Suharekës për vitin 2019 për mbrojtje të mjedisit ka planifikuar 187,000 euro ndërsa në vitin 2020 ka planifikuar që vlera buxhetore të ketë një ngritje të lehtë, në 228,000 euro. Ndërsa Komuna e Mamushes në planifikimin e saj buxhetor për vitin 2020 ka paraparë ulje të ndjeshme të mjeteve financiare për mbrojtjen e mjedisit në krahasim me vitin 2019. Sipas informatave zyrtare të pranuar nga Komuna e Mamushes del se në vitin 2019 shuma e buxhetit të planifikuar për mbrojtjen e mjedisit në këto komune ka qenë 165,000 euro, ndërsa për vitin 2020, planifikohet një shumë prej 70,000 eurove.

Vlera e buxhetit të paraparë për mbrojtjen e mjedisit gjatë vitit 2019 dhe 2020 mbetet e panjohur për komunat e Malishevës, Rahovecit dhe Dragashit, të cilat kanë zgjedhur të mos deklarohen, duke lënë të pa precizuar planifikimet e tyre komunale sa i përket mbrojtjes së mjedisit.

Një analizë mbi politikat mjedisore lokale si dhe pasqyrimet e gjendjes nga terreni, flet për një nevojë imediate për një përkushtim më të madh sa i përket mbrojtjes së mjedisit dhe përmirësimin e standardit të jetesës së qytetarëve të komunave të Rajonit të Prizrenit. Ndërkohë që temat me interes për t'u trajtuar mbeten pothuajse të njëjta me ato në nivel vendi. Për këtë arsye ky raport fokusohet në legjislaturën, strategjitë dhe parametrat mjedisor në nivel qendror por njëkohësisht krijon lidhshmëri me problematikat në nivel komunal, duke patur për fokus komunat e Rajonit të Prizrenit.

Ky raport ka për synim gjenerimin e burimeve të informacionit për parametrat mjedisor, që do të shërbejnë si udhëzues për politikat lokale mjedisore të së ardhmes dhe njëkohësisht si mjet informacioni për monitorimin permanent të tyre.



fig.1 Ndotja e ajrit nga termocentralet

⁵https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/Komunkate_per_media_mjedisi.pdf

Me qëllim të informimit sa më të drejtë të qytetarëve, aktivistëve, akterëve të mediave dhe monitoruesve potencial mbi rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe politikave aktive mjedisore në nivel vendi, është me rëndësi njohja e kornizës ligjore në nivel shteti. Aktualisht, sipas raportit vjetor të gjendjes së mjedisit në Kosovë, Republika e Kosovës posedon këto ligje në fuqi:

- **Ligji për mbrojtjen e mjedisit (Nr. 03/L-025)**

Qëllimi i këtij ligji është të promovojë krijimin e mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës me sjelljen graduale të standardeve për mjedis të Bashkimit Evropian.

- **Ligji për mbeturina (Nr. 04/L-060)**

Ky ligj ka për qëllim: evitimin dhe reduktimin sa më të madh të mundshëm të gjenerimit të mbeturinave; ripërdorimi i komponentëve të përdorshëm nga mbeturinat, parandalimi i ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe shëndetin e njeriut dhe deponimi përfundimtar i mbeturinave në mënyrë të pranueshme mjedisore.

- **Ligji për Ujërat e Kosovës (Nr.04/L-147)**

Ky ligj ka për qëllim kryesor të sigurojë zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin social - ekonomik të Republikës së Kosovës;

- **Ligji për Planifikimin Hapësinor (Nr.04/L-174)**

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të planifikimit hapësinor për tërë territorin e Kosovës si vlerë e përgjithshme kombëtare, përmes qeverisjes së mirë, shfrytëzimit të përshtatshëm të tokës, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

- **Ligji për Kimikate (Nr.04/L-197)**

Qëllimi i këtij ligji është menaxhimi i drejtë i kimikateve të rrezikshme, mbrojtja dhe zvogëlimi i rrezikut të mundshëm nga kimikatet të cilat mund të ndikojnë dhe të shkaktojnë pasoja të rënda për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

- **Ligji për ndryshimin dhe plotësimin (Nr.03/L-153) e Ligjit për pyjet e Kosovës (Nr.2003/3)**

Ky ligj i definon Pyjet e Kosovës si resurse kombëtare, andaj ka për qëllim që ato të udhëhiqen në atë mënyrë që të ofrojnë rendimente me vlerë dhe në të njëjtën kohë të ruhet biodiversiteti për të mirën e gjeneratave të tashme dhe të ardhshme.

- **Ligji për veprimtaritë hidrometeorologjike (Nr. 02/L-79)**

Me këtë ligj rregullohen punet hidrometeorologjike dhe menyra e kryerjes se tyre.

- **Ligji për shëndetësi publike (NR. 02/L-78)**

E definon shëndetësia publike si disiplinë e pavarur që merret me identifikimin dhe zgjidhjen e të gjitha problemeve të bashkësisë nga të gjitha pikëpamjet shëndetësore, parandalimin e sëmundjeve, hulumtimin e etiologjisë së sëmundjeve, promovimin e shëndetit, edukimin shëndetësor dhe çështjet sociale.

- **Ligji për veprimtaritë e ofertuesve të shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit (Nr. 03/L-086)**

Ky Ligj ka për qëllim të rregullojë punën e të gjithë ofruesve të shërbimeve në pronësi publike e shoqërore dhe furnizuesve të ujit dhe kanalizime dhe përcakton standardet e shërbimeve.

- **Ligji për mbrojtjen e natyrës (Nr. 03/L-233)**

Ky ligj rregullon mbrojtjen e natyrës, shfrytëzimin e qëndrueshëm të saj.

- **Ligji për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” (Nr. 04/L-086)**

Ky ligj e definon territorin e Bjeshkëve të Nemuna si tërësi hapësinore e cila veçohet me vlera dhe raritete natyrore, me numër të madh të ekosistemeve të rëndësishme pyjore dhe ekosisteme të tjera të ruajtura, me numër të konsiderueshëm të llojeve endemike dhe relikte, me karakteristika të pasura gjeomorfologjike, hidrologjike dhe peizazhore që kanë rëndësi shkencore, edukativo – arsimore, kulturore – historike, rekreative - turistike dhe veprimtaritë që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik sipas kritereve mjedisore.

- **Ligji për Parkun Kombëtar “Sharri” (Nr. 04/L-087)**

Ky ligj e definon territorin e maleve të Sharrit si tërësi hapësinore që veçohet me vlera dhe raritete natyrore, me pyje të ruajtura, me numër të madh të ekosistemeve të rëndësishme pyjore dhe ekosisteme të tjera, me numër të konsiderueshëm të llojeve të ruajtura endemike dhe relikte, me karakteristika të pasura gjeomorfologjike, hidrologjike, si dhe me vlera shkencore, kulturore, historike, peizazhore, sportive, rekreative – turistike dhe veprimtaritë që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik sipas kritereve mjedisore.



fig.2 Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”



fig.3 Parkun Kombëtar “Sharri”

- **Ligji për Gjuetinë (Nr. 02/L-53)**

Qëllimi i ligjit është ruajtja e tërësisë së ekosistemit dhe baraspeshës ekologjike, mbrojtja adekuatë e kafshëve të egra, sigurimi i mirëqenies dhe kushteve për shfrytëzim ekonomik të resurseve, nevoja për siguri dhe standardin e etikës së gjahtarëve.

- **Ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis (Nr. 03/L-214)**

Qëllimi i këtij ligji është parandalimi ose zvogëlimi i ndikimeve negative të projekteve të propozuara publike dhe private dhe në këtë mënyrë të kontribuojë në ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit, mbrojtjen e shëndetit të njeriut si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

- **Ligji për vlerësim strategjik mjedisor (Nr. 03/L-015)**

Qëllimi i këtij ligji është që me vlerësim strategjik mjedisor të planeve dhe programeve, të sigurojë shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

- **Ligji për produktet biocide (Nr. 03/L-119)**

Qëllimi kryesor i këtij projektligji është që të caktojë dhe të rregullojë kushtet për vendosjen në treg dhe përdorimin e substancave aktive që përdoren për prodhimin e produkteve biocide në territorin e Republikës së Kosovës dhe me këtë të mbrojnë shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe të mjedisit.

- **Ligji për taksën rrugore dhe ekologjike të automjeteve (Nr. 04/L-117)**

Me këtë ligj rregullohet taksa rrugore për automjete të regjistruara në Republikën e Kosovës dhe vendosja e taksës ekologjike për automjetet e regjistruara në Kosovë dhe për automjetet e huaja. Taksa ekologjike ka për qëllim ngritjen e cilësisë së mbrojtjes së mjedisit.

- **Ligji për Inspektoratin e mjedisit, ujërave, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit (Nr.04/L-175)**

Me këtë ligj rregullohen parimet, organizimi dhe mbikëqyrja inspektuese, koordinimi i mbikëqyrjeve inspektuese, të drejtat, detyrat, autorizimet e inspektorit, të drejtat, detyrimet e subjekteve të mbikëqyrjes, procedura për kryerje të mbikëqyrjes inspektuese dhe çështje tjera me rëndësi që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen inspektuese.

- **Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Nr. 04/L-082)**

Në Kapitullin XXVIII gjegjësisht nga neni 347 deri 364 përfshin veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore.

Përpos legjislaturës së pasur sa i takon masave ligjore në fuqi si dhe përafërimit të kësaj legjislature me ligjet evropiane në fuqi, institucionet e Kosovës kanë aprovuar një varg strategjish dhe programesh me qëllim të mbrojtjes së mjedisit dhe fuqizimin e sektorëve të caktuar mjedisor, përfshirë këtu (ato të cilat janë ende aktive):

- **Strategjia Mjedisore e Kosovës dhe Plan i Kombëtar i Veprimit Mjedisorë 2013-2022**
- **Strategjia dhe Plan i Veprimit për Biodiversitet 2011-2022**
- **Strategjia për Cilësinë e Ajrit 2013-2022**
- **Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2022**
- **Plan i veprimit për Zbatimin e Strategjisë për Menaxhimin e Mbeturinave 2013-2022**
- **Strategjia për Ndryshimet Klimatike për Kosovën 2014-2024**
- **Strategjia Shtetërore e Ujërave 2015-2022**
- **Plan Hapësinor i Kosovës- Strategjia për Zhvillimin Hapësinor të Kosovës 2010-2020**
- **Plan Hapësinor për Parkun Kombëtar “Sharri” 2013-2022**
- **Plan Hapësinor për Monumentin e Natyrës me Rëndësi të Veçantë “Ujëvarat e Mirushës” 2014-2023**
- **Plan Hapësinor për Zonën e mbrojtur me Interes të veçantë “Beteja e Koshares” 2014-2023**
- **Plan Hapësinor për Zonën me Interes të veçantë “Shtabi i përgjithshëm i UÇK-së, Kleçkë dhe Divjakë” 2014-2023**
- **Plan Hapësinor për Zonën me Interes të veçantë “Fusha e Mihjes së re” 2010-2020**
- **Plan Menaxhues për Parkun Kombëtar “Sharri” 2015-2024**
- **Plan Kombëtar i Veprimit për Burimet e Ripërtritshme të Energjisë 2013-2020**
- **Strategjia Minerare e Kosovës 2012-2025**
- **Strategjia e Zhvillimit të Pylltarisë 2010-2020**
- **Strategjia për Konsolidimin e tokës 2010-2020**
- **Strategjia për Mbrojtjen e Klimës në Sektorin e Pylltarisë në Kosovë 2013-2020**
- **Strategjia e Transportit Multimodal dhe Plan i Veprimit 2012-2021**

Roli i nivelit lokal në angazhimin për mbrojtjen e mjedisit është po aq i rëndësishëm sa edhe ai i nivelit qendror. Definuar në Strategjinë për Mbrojtjen e Mjedisit 2013-2022, Komunitat duhet të miratojnë Planet Lokale të Veprimit në Mjedis-PLVM dhe programet për mbrojtjen e mjedisit në përputhje me SMM dhe Planin e Kosovës për Veprim në Mjedis, sipas intereseve specifike të saj. Gjithnjë sipas këtij dokumenti, Komunitat janë të inkurajuara që gjatë hartimit të Planeve Lokale të Veprimit në Mjedis dhe programeve të tjera relevante, të përfshijnë komunitetin, OJQ-të, organizatat profesionale dhe komunitetin e biznesit. Lidhur me përmbushmërinë e këtyre obligimeve si dhe zbatueshmërinë e këtyre planeve dhe programeve, Komunitat i raportojnë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.



fig.4 Ujvarat e Mirushës



fig.6 Fusha e Mihjes së Re



fig.5 Xeheror nga Miniera e Trepçës

FORCAT SHTYTËSE DHE PRESIONET NË MJEDIS

Në analizën e gjendjes së mjedisit me fokus në komunat e shqyrtuara në këtë raport, njëlloj si në atë në nivel vendi, duhet të mirret në shqyrtim ndikimi i forcave shtytëse, përfshirë këtu zhvillimet sociale, demografike dhe ekonomike të njësive urbane apo rurale si dhe trendet e jetës, prodhimit dhe konsumit.

POPULLSIA - Rritjet në shifrat demografike dhe posaçërisht dendësinë e popullsisë, raportohet të kenë ndikuar në nivel vendi, duke ndikuar në raportin e prodhimit dhe konsumit. Rritja e popullsisë dhe parametrat e rritur në raportin prodhim-konsum, paraqesin kanosje për mjedisin e Kosovës në përgjithësi dhe të komunave të saj në veçanti. Me rritjen e dendësisë së popullsisë, nga 62.7 % sa raportohet të ketë qenë në vitin 1948 në 167 % në vitin 2013 për kokë banori në m², mjedisi në Komunat e Kosovës është ndikuar nga urbanizmi i shpejtë, ndërtimet e mëdha të objekteve të banimit si dhe ato industriale, shfrytëzimin e tokës, krijimin e mbeturinave, rritjen e shkallës së prodhimit dhe shfrytëzimit të resurseve etj. Që të gjitha bashkë përbëjnë kanosësit më të mëdhenjë të mjedisit në Kosovë.

URBANIZMI - Ndër kanosësit e tjerë të mjedisit të komunave të Kosovës, e posaçërisht zonave urbane, mund të konsiderohet procesi i urbanizmit. Dyndjet e mëdha të popullsisë pas '99tës kanë ndikuar që në Kosovë të kemi mbipopullim në mjediset urbane dhe depopullim të viseve rurale. Kjo ka ndikuar në shtimin e kërkesës për ndërtim intenziv në mjediset urbane, shumë herë me shkelje ligjore dhe pa kritere urbanistike. Kanosja më e madhe e këtij procesi lidhet ngushtë me mungesën e infrastrukturës, të përcjellur nga një sistem i pakontrolluar i hudhjes së mbeturinave, rritjes së sasisë së ujërave të zeza të cilat përfundojnë në mjedise natyrore të shëndosha, gjendje shëndetësore diskutabile etj. Mjedisi i komunave me karakter urban është në kanosje permanente edhe nga komunikacioni i shtuar dhe vënia në qarkullim e një numri të madh të automjeteve (kryesisht të vjetra) të cilat paraqesin ndotësit më të mëdhenjë të ajrit gjithandej Kosovës, e edhe komunave të rajonit të Prizrenit.

RESURSET NATYRORE - Mjedisi i vendit tonë është duke u ndikuar në mënyrë të vazhdueshme si rezultat i shfrytëzimit të pakontrolluar të resurseve natyrore, përfshirë këtu shfrytëzimin e ujërave, të masës drunore si dhe të materialeve të tjera natyrore siç është guri, mineralet e ndryshme etj. Në një pasqyrë të përgjithshme në nivel të Kosovës, Komuna e Prizrenit (së bashku me Komunën e Pejës) cilësohet të ketë më së shumti operatorë ekonomik të cilët si veprimtari kryesorë kanë seperacionin e gurit dhe të mineraleve tjera. Në rradhën e shfrytëzimit të resurseve natyrore vlen të listohet shfrytëzimi i pakontrolluar i ujërave nga ana e ujësjellësve publik, në përmbushje të kërkesave të konsumatorëve për amvisëri apo edhe bujqësi. Kanosje për mjedisin paraqet edhe shfrytëzimi i pakontrolluar i inertëve - zhavorit të lumenjve, kryesisht për nevoja të industrisë së ndërtimit, duke ndikuar drejtpërsëdrejti në prishjen e ekosistemit të lumenjve dhe shtratit të tyre dhe duke dërguar në mundësitë e vërshimeve të pakontrolluara. Masa drunore e pyjeve të komunave të vendit tonë poashtu është duke u kanosur nga shfrytëzimi për djegie, ndërtim apo qëllime të tjera, duke ndikuar drejtpërsëdrejti në cilësinë e ajrit dhe në përgjithësi në klimën tonë.



fig.7 Koncentrimi i operatorëve ekonomik me aktivitet seperacionin minerar në Komunën e Prizrenit

PËRDORIMI I TOKËS - Zvogëlimi i tokave të shfrytëzuara për bujqësi dhe rritja e sipërfaqeve të cilat për destinim kanë vendbanimet, livallet, kullosat, pyjet etj. paraqet poashtu ndër ndikuesit më të mëdhenj në cilësinë e mjedisit.

Përgjatë analizës së kushteve mjedisore në nivel vendi në përgjithësi, dhe për komunat e rajonit të Prizrenit në veçanti, është e nevojshme që përveç forcave shtytëse të shqyrtohen edhe presionet në mjedis të cilat paraqesin zhvillime në mjedis që rezultojnë me: lirimin e substancave fizike dhe biologjike (p.sh. emitimin e CO2 në atmosferë), përdorimin e buri-meve natyrore (p.sh. përdorimin e zhavorit dhe rërës për ndërtim), përdorimin e tokës për nevoja të ndryshme (p.sh. përdorimin e tokës për ndërtimin e infrastrukturës) etj.

INDUSTRIA - Përpos që paraqitet si shtytës për zhvillimin ekonomik të vendit tonë, industria mund të konsiderohet ndër ndikuesit më të mëdhenj si rezultat i harxhimit konstant të resurseve natyrore, ujërave, energjisë etj; kanosjes së shëndetit të qytetarëve dhe prodhimit të numrit të madh të mbeturinave të cilat mbeten të patrajuara.

TRANSPORTI - Mjedisi ynë, me theks në atë urban, mund të konsiderohet të jetë i kanosur në mënyrë të vazhdueshme nga numri i madh i automjeteve në qarkullim, të cilat përmes gazrave të liruara ndikojnë drejtpërsëdrejti në cilësinë e ajrit, ujit dhe tokës si dhe në degradimin e habitateve.

ENERGJIA - Bilanci në mes të prodhimit të energjisë dhe ruajtjes së mjedisit paraqet ndër sfidat më të mëdha të vendit tonë, kjo për faktin se çfarëdo qoftë mënyra e prodhimit të energjisë, i tërë procesi i prodhimit të saj përbën ndër presionet më të mëdha të mjedisit.

BUJQËSIA - Duke lënë anash trendet pozitive të rritjes së prodhimtarisë bujqësore në vendin tonë, raportet e mjedisit konsiderojnë se prodhimi i produkteve ekologjike është ende i papranishëm në tregun tonë. Sidoqoftë, bujqësia përbën një ndër mundësitë për të ndikuar në mjedis, nëse mirret në konsideratë përdorimi i qëndrueshëm i tokës dhe përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore.

PYLLTARIA - Pylltaria mund të konsiderohet ndër atributet më me vlerë dhe ndikuesit më të mëdhenj në mjedis, me rëndësi të madhe në ekuilibrimin ekologjik dhe mjedisor në funksion të ruajtjes së bilancit natyror. Pyjet ndikojnë në rregullimin natyror të klimës, ruajtjes së cilësisë së tokës dhe ajrit si dhe paraqesin resurse natyrore të ripërtëritshme, me mundësi shfrytëzimi në industri dhe fushëveprime të tjera.

TURIZMI - Me shtuarjen e kërkesës për zhvillimin e turizmit në vendet tona, e posaqërisht destinacionet turistike të komunave të rajonit të Prizrenit, rreziku për degradimin e mjedisit natyror nga ndërtimet e destinacioneve turistike, menaxhimi jo i duhur i sipërfaqeve gjelbëruese dhe atyre ndërtimore, zhdukja e biodiversitetit, hudhja e pakontrolluar e mbeturinave etj., është gjithmonë e më shumë në rritje. Raportet e mjedisit në nivel vendi sugjerojnë që politikat lokale dhe qendrore duhet të fokusohen në minimizimin e këtyre ndikimeve negative në njërën anë, dhe në promovimin e turizmit të qëndrueshëm dhe ekoturizmit në anën tjetër.

Gjendja e mjedisit tonë raportohet të jetë në ndryshim të vazhdueshëm, si rezultat i presioneve të vazhdueshme dhe ndikimeve mjedisore të lartëpërmendura. Me qëllim të mbrojtjes së mjedisit tonë, është e rëndësishme të trajtohen fushëveprime të caktuara me interes si:

MBROJTJA E AJRIT - Duke qenë se ajri përbën ndër atributet kryesore të mjedisit të shëndetshëm, ndotja e tij paraqet kanosje të drejtpërdrejtë për mirëqenien e banorëve të komunave të rajonit tonë. Ndotja e ajrit ndikohet paralelisht nga aktivitetet njerëzore, ndikimet natyrore, transporti dhe llojet e tij, energjia, lëndët djegëse etj. Lidhur me këtë, Strategjia dhe Plani i Veprimit për Cilësi të Ajrit⁶ obligon komunat, përveç akterëve të tjerë, që të angazhohen në ruajtjen e cilësisë së ajrit.

MBROJTJA E UJIT - Ruajtja dhe parandalimi i ndotjes së ujit si burim esencial i jetës, përbën një ndër parakushtet për mbrojtjen e mjedisit tonë. Parandalimi i ndotjes së ujërave nëntokësore dhe mbitokësore, racionalizimi i shfrytëzimit të ujit të pijes, ruajtja e pastërtisë së lumenjve, etj., përbëjnë disa nga masat e nevojshme në drejtim të angazhimit për mbrojtjen e resurseve ujore në komunat tona. Rajoni jug cilësohet të jetë i pasur sa i takon resurseve ujore, andaj shfrytëzimi racional dhe parandalimi i ndotjes është përmbajtësor në ruajtjen e shëndetit publik si dhe zhvillimin ekonomik.




fig.8 Rrjeti i resurseve ujore në Kosovë dhe konsentrimi i tyre në komunat e rajonit të Prizrenit

⁶http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Strategjia_per_cilesine_e_Ajrit

MBROJTJA E TOKËS - Parandalimi i degradimit të sipërfaqeve tokësore përbën ndër sfidat më të mëdha të kanosjes së mjedisit në komunat tona, e në veçanti në zhvillimet që kanë zënë vend në mjediset urbane dhe në tokat bujqësore. Komunat, përpos angazhimit për realizimin e objektivave të paracaktuara në Strategjinë për Konsolidimin e Tokës 2010 – 2020 dhe Strategjinë për Mbrojtjen e Mjedisit 2013 – 2022, sugjerohen të angazhohen në vetëdijesimin e komunitetit për shfytëzim sa më racional të sipërfaqeve tokësore, të promovojnë hapësirat e gjelbra, të rivitalizojnë hapësirat e dëmtuara etj.

MBROJTJA E ZONAVE TË MBROJTURA TË NATYRËS - Përpos attributeve dhe fushëveprimeve të përgjithshme me interes në mbrojtje të mjedisit, territore të caktuara janë të karakterizuara si zona të mbrojtura të natyrës me qëllim të ruajtjes së cilësive mjedisore, larmisë biologjike dhe peisazhore që ato bartin. Në mesin e 116 zonave të mbrojtura në Kosovë, rajoni i jugut cilësohet për Parkun Kombëtar “Mali Sharr”.



fig.9 Harta e Zonave të Mbrojtura – Koncentrimi i Parkut Kombëtarë “Mali Sharr” në rajonin e jugut

MBROJTJA E BIODIVERZITETIT - Mbrojtja e llojllojshmërisë jetësore në tokë, paraqet poashtu ndër fushëveprimet më me interes në mbrojtje të mjedisit dhe sigurimit të bilancit jetësor në të. Klima, pozita gjeografike, resurset ujore etj., bëjnë që komunat e rajonit të Prizrenit të kenë një diversitet të pasur peisazhor dhe biologjik, andaj mbrojtja, menaxhimi dhe rikuperimi i burimeve të rrezikuara është më se e nevojshme.

MBROJTJA NGA MBETURINAT - Aktiviteti njerëzor dhe ai prodhues-industrial përbëjnë ndër kanosësit kryesor të mjedisit, m'u për faktin se këto aktivitete përcillen me prodhimin e një numri të konsiderueshëm të mbeturinave, të cilat rëndom mbeten të pa sistemuara dhe të pashfrytëzuara për procesin e riciklimit. Raportohet se gjenerimi i mbeturinave për kokë banori në komunat përkatëse në Kosovë është trend në rritje. Edhe pse ekzistojnë iniciativa individuale për riciklimin, ripërdorimin dhe trajtimin e mbeturinave, një gjë e tillë nuk praktikohet në nivel komunash. Shqetësim tjetër janë edhe deponitë e mbeturinave, të cilat paraqesin kanosje për shëndetin publik. Aktualisht në nivel vendi operojnë deponitë sanitare regjionale, ato komunale si dhe stacionet e transferit. Në rajonin jug ekziston deponia sanitare në Komunën e Prizrenit e cila u shërben Komunave të Gjakovës, Rahovecit, Mamushës, Malishevës dhe Suharekës dhe deponia josanitare e Komunës së Dragashit. Deponia në Komunën e Prizrenit, e stacionuar në Landovicë, sipas raportit mbi gjendjen e menaxhmentit të mbeturinave komunale në Kosovë⁷ të vitit 2018 paraqet rrezik mjedisor për faktin që sistemi i pompimit ujr mungon dhe ujërat nga deponia me ujërat sipërfaqësore rrezikojnë të përzihen.




fig.10 (a) Deponitë sanitare në rajonin e Prizrenit;
(b) Deponitë ilegale në rajonin e Prizrenit

⁷ <https://www.ammk->

[rks.net/repository/docs/Menaxhimi i Mbeturinave Komunale ne Kosove Raport mbi gjendjen 2018.pdf](https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Menaxhimi_i_Mbeturinave_Komunale_ne_Kosove_Raport_mbi_gjendjen_2018.pdf)

Rajoni i Prizrenit njihet si ndër pjesët më pjellore të Kosovës. Njihet për nga sasia e ujërave rrjedhëse, por edhe për të reshura, sidomos gjatë stinës dimër - pranverë. Gjithashtu njihet edhe për trashëgimi kulturore natyrore dhe urbane. Sidomos sipërfaqet e parqeve dhe zonave të mbrojtura, monumentet e natyrës, janë kryesore në këtë anë, burimet e ujërave dhe biodiversiteti i pasur.

Në shikim të parë rajonet bujqësore duken të mirëmbajtura dhe të gjelbëruara, por nëse bëhet një analizë më e thelluar shihen telashet dhe shqetësimet mjedisore. Shqetësimet mjedisore bazën e kanë në veprimtaritë që zhvillohen në rajonin e caktuar. Në komunat e rajonit të Prizrenit tradicionalisht janë të njohura veprimtaritë zejtare, bujqësore, pemëtari, vreshtari, turizmi malor, gjuetia dhe blegtoria. Kohët e fundit janë shtuar edhe nxjerrja e zhavorit dhe gurëthyesit, si dy veprimtari me ndikim mjaft të lartë në mjedis. Zhvillimi i këtyre veprimtarive nga njeriu ushtron tryzni në mjedis sikurse në vijim.

Problemet kryesore:

- **PËRDORIMI I TOKËS BUJQËSORE - NDIKIMET NË MJEDIS: TOKË, UJËRA...**

Që nga burimi i Drinit të Bardhë deri në Suharekë shtrihet një tokë pjellore ku kultivohen drithërat, perimet, pemët dhe vreshtaria. Gjithashtu ky rajon njihet edhe për ujëra rrjedhëse, ku përveç Drinit rrjedhin edhe Bistrica e Pejës, Prizrenit dhe e Deçanit, Ereniku, Krena, si dhe përroska të tjera. Këto mundësojnë që të ketë një përkushtim të shtuar të banorëve për agrikulturë, por edhe për zhvillim të rajonit. Bujqësia, agrikultura në përgjithësi, përveç sigurimit të jetesës dhe të mirave materiale që ka për banorët, kohët e fundit ngrit edhe një varg shqetësimesh mjedisore. Sot nevoja për rritjen e prodhueshmërisë bujqësore, si dhe për mbrojtjen e bimëve nga dëmtuesit e shumtë është e madhe meqenëse janë duke u përdorur një listë e gjerë preparatesh kimike. Një pjesë e tyre thuaja janë të domosdoshme për përdorim, sidomos për mbrojtjen e bimëve nga dëmtuesit e shumtë, të cilët po krijojnë imunitet ndaj preparateve kimike. Në shumë raste, për shkak të mungesës së informacionit të duhur për dukurinë e imunitetit të dëmtuesit, por edhe për efektet anësore të preparateve kimike, bujqit rrisin sasinë e tyre duke menduar se do ta rrisin efikasitetin e veprimit të tyre ndaj dëmtuesve.



fig.11 (a) Gryka e Rugovës (b) Lumi Krena - Gjakovë (c) Burimi i Drinit Bardhë

Ky veprim mund të ndikojë në prishjen e zinxhirit të ushqimit, përmes dëmtimit të organizmave të cilët janë të nevojshëm për bimët, ose për ekologjinë e vendit.

Ngjashëm ndodh edhe me përdorimin e plehrave kimik. Përmasat e parapara me udhëzuesit për sasinë e mjaftueshme për ushqimin e bimëve tejkalohen duke menduar se rritja e sasisë së plehrave kimike shton prodhimtarinë dhe rrit rendimentin. Rritja e sasisë së përbërësve kimik, (NPK, NAG, KAN) mund ta rrisë sasinë, por në të njëjtën kohë ta dëmtojë dheun duke dëmtuar mikroorganizmat të cilët shërbejnë qoftë si ushqyes ose ajruer të bimës.

Dihet se gjatë të reshurave të shiut, ose gjatë ujitjes, një sasi e këtyre përbërësve kimik bartet në lumenj ose depërton në ujërat nëntokësore. Depërtimi i tyre në ujëra dëmton ekosistemin ujor, ose shkakton telashe të tjera, siç është p.sh. shumimi i algave si pasojë e depërtimit të sasisë së lartë të azotit (N) në ujë. Rritja e sasisë së azotit në ujë ndikon në shumimin enorm të algave në ujëra (njihet si lulëzim i algave), sidomos në liqe, duke penguar depërtimin e dritës në thellësi të ujit. Kjo pastaj ndikon në dëmtimin (vdekjen) e botës nënujore. Kësi dukurish shfaqen shpesh në liqene, sidomos ato artificiale, siç është Liqeni i Radoniqit, ku ka pasur dukuri të këtilla. Atëherë çfarë duhet të bëjmë që ta zbusim këtë problem? Sasia e përdorimit të plehrave kimike në bujqësi dhe kopshtari duhet të bëhet në përputhje me deklaratën e prodhuesit, gjegjësisht me konsultim me agronomin përkatës. Duhet penguar ujërat e shiut, ose të ujitjes që të depërtojnë në lum ose në liqe.

• KOMPOSTIMI I MBETJEVE ORGANIKE-BUJQËSORE

Nëse kaloni pas të korrave, ose në stinën e vjeshtës kur vilen perimet, kur pastrohen arrat dhe perimet nga pjesët e papërdorshme, sheh me tonelata mbetje të bimëve. Ato hidhen kudo, ose depozitohen në gropa, deponi të egra ose në lumenj. Një pjesë e tyre digjen ose shpërbëhen/kalben ashtu në natyrë të hapur. Përbërja e tyre është e shumëllojshme, siç janë vet pemët e perimet të llojllojshme. Ato mbetje janë një pasuri e mirë, e cila nuk shfrytëzohet thuaja fare nga bujqit dhe kopshtarët. Për fat të keq një pjesë e kashtës, tallës, gjetheve digjen duke menduar se kështu po zbusin problemin e mbeturinave. Por kështu mjedisit, tokës bujqësore sidomos, i shkaktohen edhe dhjetëra probleme të tjera, si dëmtimi i ajrit, ndotja e ujërave, rritja e numrit të brejtësve etj.

Sot në vendet e zhvilluara, dhe me traditë edhe në agrikulturë edhe për mjedis, gjithë kjo sasi e mbetjeve paraqet një burim të mirë për pasurim. Përveç pasurimit, shfrytëzimi i këtyre mbetjeve ndikon shumë në mbrojtjen e mjedisit, duke zvogëluar sasinë e mbetjeve, por edhe rrezikun nga ndotja. Ndikimet vërehen edhe në buxhetin familjar. Sasinë e plehrave artificial që bujqit blejnë, me atë buxhet do plotësonin nevojat tjera familjare ose do të investonin në pajisje bujqësore.

Zgjidhja është kompostimi. Secili bujk, familje, shumë lehtë do ta ndërtonte një kompostore. Kompostim i prodhuar do ta kompensonte plehun kimik. Toka do të mbrohej nga ndotja dhe varfërimi i dheut nga përbërësit kimik të cilët i përbëjnë plehrat, varësisht nga qëllimi i përdorimit të tyre. Gjithashtu, përdorimi i kompostit do ta pasurojë tokën/dheun me përbërësit e nevojshëm për bimën, e jo ta varfërojë atë siç këtë e bëjnë plehrat kimike. Sidomos dëmtimi i mikroorganizmave në dheun bujqësor, skraja ose insekte të tjera, të cilat përveç plehërimit ndikojnë edhe për ajrosjen e rrënjëve të bimëve.

Përdorimi i plehut organik në vend të plehrave kimike do t'i stimulonte shumimin edhe të këtyre mikroorganizmave dhe gjallesave të tjera të nevojshme për rritjen e bimës. Përdorimi i plehut organik, nuk mund t'i plotësojë të gjitha nevojat e bujqve, sidomos ata që kanë sipërfaqe të mëdha të tokës. Por përdorimi i kompostit do ta ulë në masë përdorimin e plehrave kimike si dhe do ta mbrojë tokën bujqësore nga ndotja dhe nga varfërimi i dheut nga përbërësit kimik.

Si mund të kompostohet? Janë disa mënyra. Kompostimi në kompostore moderne, por edhe në mënyrë të thjeshtë, qoftë në thasë plastmase, ose duke groposur mbeturinat organike dhe duke u kujdesur për to. Sot ende kanë nevojë për më shumë informacion, bujqit sidomos.



fig.12 Kompostimi

- **Krijimi i mbeturinave - menaxhimi i tyre**

Një ndër problemet mjedisore, dhe jo vetëm, sot janë mbeturinat. Pasi që ne bëjmë pjesë në shoqëritë konsumuese, pa ndonjë plan konsumi, prandaj edhe krijojmë shumë mbeturina. Tani më në botën e qytetëruar mbeturinat janë bërë pjesë e kulturës së menaxhimit të tyre. Te ne kjo mungon. Jo vetëm kultura e menaxhimit individual, familjar por edhe institucional. Sipas Raportit të MMPH (2018) Kosova prodhon çdo ditë 0.78 kg mbeturina për kokë banori, ndërsa veçohet Rajoni i Pejës me 1.03 kg për kokë banori.⁸ Problemet më të mëdha si për mjedisin ashtu edhe për shëndetin, jetën, e njeriut paraqesin mbeturinat. Janë probleme madhore për shkak të përbërjes së tyre, shpesh edhe me rrezikshmëri të lartë. Vetëm nëse i ofrohem një grumbulli ose koshi mbeturinash do të shohim një përbërje të llojllojshme të tyre. Kjo varet nga prejardhja dhe përbërja e tyre. Këtu nuk e shohim të nevojshme të flasim për natyrën dhe llojet e tyre, por përbërja dhe ndikimi i tyre qoftë në resurset mjedisore qoftë në njeriun është i domosdoshëm të sqarohet. Kjo llojllojshmëri e mbeturinave është rezultat i mos ndarjes së tyre sipas përbërjes, ose prejardhjes së tyre. Për fat të keq në mesin e mbeturinave shpesh hasen, hidhen, edhe mbeturina të rrezikshme, siç janë metalet e rënda, vajrat e përpunuara ose ambalazhi në të cilat ato ruhen apo blihen, pastaj ushqime, mbetje të ngurta, plastikë, letër, metale etj.

Kohët e fundit është shtuar veprimtaria ndërtimore, renovime, etj., dhe me këtë është rritur sasia e mbeturinave të ngurta, të cilat në shumicën e rasteve përzihen me mbeturinat tjera. Të gjitha këto mbetje mund të ripërdoren dhe ridestinoen për qëllime të tjera. Përveç ndotjes këto mbetje paraqesin edhe një imazh të keq për vendbanimet, buzë rrugëve ose edhe në hapësirat publike, lumenj dhe në pyje. Këto pamje mund t'i shoh njeriu nga Istogu deri në Prevallë e Vërmicë dhe Dragash. Shpesh paraqesin edhe problem ndërkufitar. Për këtë kohë më parë pati një reagim nga Republika e Shqipërisë për depërtimin e sasisë së madhe të mbeturinave, sidomos të shisheve plastike, në liqe nëpërmjet Drinit të Bardhë.



fig.13 Ndotja e Lumbardhit nga mbeturinat

⁸ MMPH (2018). Raporti për menaxhimin e mbeturinave, fq.13.

Me politikat mjedisore të hartuara nga MMPH dhe Parlamenti i Kosovës, është paraparë që të bëhet ndarja dhe riciklimi i mbeturinave sipas përbërjes së tyre. Por edhe pse në disa institucione bëhet ndarja e mbeturinave në shporta të veçanta, p.sh., në disa shkolla, ato sërish barten dhe deponohen në të njëjtën vend. Depozitimi i këtillë i mbeturinave, pa i ndarë ato sipas përbërjes, paraqesin rrezik të vazhdueshëm për mjedisin dhe për vet shëndetin e njeriut. Edhe më i rrezikshëm është procesi i zhbërjes së tyre dhe lidhjet/kompozimet kimike që shkaktohen nga zhbërje në të njëjtin vend. Rajoni i Prizrenit ka disa deponi, të ndërtuara me standarde, si p.sh., ajo në Landovicë, por vet fakti që aty grumbullohen të gjitha llojet e mbeturinave, pa ndarje paraprake, paraqet rrezik të vazhdueshëm. Përveç liritimit të gazrave nga zhbërja, nga mbeturinat organike kemi edhe shumim enorm të organizmave të cilët mund të jenë bartës të sëmundjeve të ndryshme. Edhe më keq kur në këto deponi kanë qasje qentë endacak, mace dhe shpezët. Ato bartin jashtë deponisë mikroorganizma të rrezikshme për njeriun. Sipas standardeve për depozitimin e mbeturinave ato duhet të mbulohen vazhdimisht, shtresa-shtresa me dhe, gjë që nuk ndodh në të gjitha deponitë. Pas mbulimit me dhe nuk përfundon rreziku nga mbeturinat. Zhbërja e mbeturinave, sidomos ato organike, liron gazra kimike aspak të përshtatshme për mjedisin dhe njeriun, siç janë metani dhe gaze të tjera.

Cila është zgjidhja?

Siç kemi cekur më lartë, zgjidhja më e mirë, e lehtë dhe përfituese, për mbeturinat organike është kompostimi i tyre. Të tjerat duhet të riciklohen ose ripërdoren, kur kjo lejohet.



fig.14 Ndarja dhe riciklimi i mbeturinave



fig.15 Deponi e mbeturinave

• Riciklimi dhe ripërdorimi

Procesi i riciklimit të mbetjeve fillon qysh nga burimi i krijimit të tyre. Nëse nisemi nga familja, si bërthamë e shoqërisë, atëherë nga aty duhet filluar me përkujdesjen për llojin dhe sasinë e mbetjeve. Cekëm më lartë se shquhemi si shoqëri konsumuese. Ndodh shpesh të blejmë sasi produktesh për të cilat nuk kemi shumë nevojë, ose na vie keq të blejmë ½ kilogrami, por blejmë 1kg. Gjysma e produktit hidhet. Me këtë bëhet edhe krijimi i sasisë së mbetjeve. Problem tjetër tek konsumi kemi përzgjedhjen e llojit të ambalazhit. Tani në treg ka vërshuar plastika për sasinë dhe për çmimin e ulët. Me legjislacionin në fuqi nuk është rregulluar çështja e përdorimit të plastikës, qeseve të ndryshme ose ambalazhit të lëngjeve. Ato sot shihen në të gjitha anët: fusha, lumenj, pyje. Për shkak të peshës së tyre ato i bartë era gjithandej. Dihet që plastika është produkt i proceseve dhe elementeve kimike, të cilat dëmtojnë mjedisin, por edhe shekulli i zhbërjes së tyre është i gjatë.

Në bazë të raportit të Riinvest (2015), një problem, dhe mangësi e përbashkët e komunave në Kosovë është niveli i ulët i informatave për shumicën e problemeve dhe shqetësimeve mjedisore. Sidomos ka mangësi të theksuara në informimin e qytetarëve për hapat që duhet ndjekur në menaxhimin e mbetjeve ose edhe të ripërdorimit të tyre, ridestinimin e tyre për qëllime të caktuara jo në dëm të mjedisit.

Sot me ligj, por edhe me konventa ndërkombëtare, si p.sh. Konventa e Aarhusit, secili produkt duhet ta ketë edhe shenjën identifikuese për përmbajtjen dhe përbërjen kimike, nëse është e riciklueshme ose jo, nëse mund të hidhet në deponi ose jo. Për këto të dhëna qytetarët, sidomos pjesa e cila merret me bujqësi, kanë pak informata se si duhet të vepronë në raste të tilla. Ende shumë vendbanime, rurale sidomos, nuk kanë grumbullim të organizuar të mbeturinave. Si pasojë e kësaj ende kemi deponi të egra ku vendosen mbeturinat. Pasojat nga këto deponi janë të paparashikueshme. Për shumë nga këto pasoja qytetari nuk ka informata të sakta. Për ta me rëndësi është largimi nga oborri, çfarë ndodh më tutje nuk kanë informata. Edhe sektori jo qeveritar nuk dëgjohet shumë në zonat rurale. Edhe institucionet përgjegjëse për mjedisin më shumë janë fokusuar në zonat urbane për shkak të frekuencës më të madhe të qytetarëve se sa në zonat rurale. Por harrojnë që për shkak të natyrës së veprimtarisë mbeturinat në zonat rurale duan vëmendje sikurse ato në zonat urbane.



fig.16 (a) Simbolet 1 (PETE) dhe 2 (HDPE) janë gjithmonë të riciklueshme,
(b) Simbolet 3 (PVC), 6 (PS) dhe 7(OTHER) nuk janë kurrë të riciklueshme dhe
(c) Simbolet 4 (LDPE) dhe 5 (PP) përcaktojnë që plastika mund të jenë e riciklueshme.

Çfarë duhet bërë?

Duhet shtuar nivelin e informimit të barabartë të qytetarëve lidhur me pasojat nga mbeturinat, pastaj lidhur me menaxhimin e tyre. Gjithashtu duhen politika stimuluese për zonat rurale për t'i ndihmuar ata në zbutjen e problemit me mbeturinat. Pastaj organizimi i grumbullimit të tyre është i domosdoshëm. Ia vlen edhe lirimi nga pagesa për bartjen e tyre. Mbatja e takimeve me qytetarë në zonat rurale me pjesëmarrjen e ekspertëve të bujqësisë, shëndetësisë dhe të menaxhimit të mbeturinave do të ndikojë shumë në informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet menaxhimit të mbeturinave. Duhet stimuluar edhe shoqëria civile, e cila me projekte të vogla do të ndihmonte shumë në zbutjen e problemeve mjedisore.

- **Dëmtimi i biodiversitetit (malor, lumor ...)**

Rajoni i Dukagjinit shquhet për llojllojshmëri të botës bimore dhe shtazore. Falë klimës që mbizotëron në këto anë, por edhe sasisë së ujërave rrjedhëse, kanë ndikuar në zhvillimin e florës dhe të faunës së kësaj ane. Begatia me florë e faunë rrit përgjegjësinë individuale dhe shoqërore për mbrojtjen dhe kultivimin e llojeve të veçanta, sidomos ato që mund të jenë të rrezikuara. Llojet e veçanta, si të bimëve ashtu edhe të kafshëve, janë pasuri kombëtare e një vendi. Dikur lumi Drini i Bardhë ka qenë i pasur me ngjalla, Bjeshkët e Rugovës dhe të Sharrit me dhinë e egër, Rrëqebullin dhe ariun, por sot të gjitha këto janë në zvogëlim të vazhdueshëm deri në rrezikim.

Biodiversiteti, ose llojllojshmëria e botës bimore dhe shtazore të një vendi konsiderohen si pasuri kombëtare. Sa më shumë lloje që të ketë, vlera e tyre është më e madhe. Larushia e florës dhe e faunës paraqet një bazë të mirë edukative dhe shkencore, por edhe burim i mirë për zhvillimin ekonomik të rajonit ku shtrihen.

Bazuar në raportet periodike të Ministrisë së Mjedisit, kjo pasuri kombëtare dëmtohet shumë nga persona të papërgjegjshëm, ose nga veprimtaritë legale dhe ilegale të njeriut. Shfrytëzimi pa kriter i resurseve të natyrës, për qëllime përfitimi, pa menduar për vlerat e tyre, bie në kundërshtim me filozofinë e zhvillimit të qëndrueshëm të një vendi. Si shembull tipik i këtij keqpërdorimi për qëllime përfitimi është shfrytëzimi i bimëve mjekuese pa kriter, siç është shembulli i Sanëzës (*Gentiana lutea*). Ajo njihet si bimë mjekuese shumë e vlefshme e cila shitet në tregun farmaceutik. Edhe pse ka hyr në Librin e Kuq vazhdon nxjerrja me rrënjë duke rrezikuar zhdukjen e saj.

Përveç gjobave dhe ndjekjes së keqpërdoruesve të kësaj bime dhe të tjera, duhet të vazhdohet më me ngulm procesi i informimit dhe vetëdijesimit të banorëve të rajonit të Prizrenit lidhur me vlerat e këtyre bimëve dhe kafshëve të mbrojtura, por edhe lidhur me pasojat e dëmtimit dhe shfrytëzimit të tyre pa kriter. Sidomos duhet të insistohet më shumë që programet shkollore të përkushtohen më shumë, pse jo edhe të kenë programe të veçanta në bazë të specifikave të rajonit, ose shkollës lidhur me këto lloje të rrezikuara.

Stimulimi i shoqërisë civile ndihmon shumë në rritjen e ndjeshmërisë qytetare për problemet mjedisore në vend.

Sot nëpër botë ekzistojnë me dhjetëra shoqata e programe të veçanta vetëm për mbrojtjen e Vidhit, i cili njohët si një ndër pemët më ekologjike, por edhe i rrezikuar për zhdukje. Rajoni i Dukagjinit është i njohur për këtë pemë, por e cila është në zhdukje dhe për të cilën ka pak informata qytetari i kësaj ane. Pse të mos organizohen grupe të rinjsh me emra të këtyre llojeve të rrezikuara për t'u dal në mbrojtje, por edhe për t'i vetëdijesuar të tjerët për rëndësinë dhe vlerat që ka një bimë a kafshë e këtillë.

Pastaj duhet një vetëdijesim i vazhdueshëm i qytetarëve lidhur me rëndësinë e zinxhirit ushqimor në natyrë, ku shkëputja e ndonjë hallke në këtë zinxhir lë pasoja për mjedisin dhe për llojin e bimës a kafshës. Ka raste kur qytetarët vrasin ose ua dëmtojnë çerdhet e të vegjëlit e shqiponjave ose skifterëve pasi që ato ua hanë pulat. Pasi që shqiponjat gjuajnë minjtë, me dëmtimin e tyre ka ndodhur shumimi enorm i minjve duke iu shkaktuar telashe të mëdha, por edhe duke rrezikuar me bartjen e sëmundjeve të ndryshme tek njeriu nëpërmjet minjve.

- **Gurëthyesit, dëmtimi i natyrës, biovidersiteti dhe ndotja e ajrit**

Një veprimtari shumë e zhvilluar, dhe fitimprurëse, sot në të gjitha anët e Kosovës janë gurë bluesit e shumtë. Dihet se Kosova ende është vend në zhvillim dhe rindërtim, prandaj edhe nevoja e madhe për një material të këtillë siç është çaklli është e vazhdueshme. Funksonimi i të gjithë këtyre gurëthyesve janë në kundërshtim me ligjin për ndikimin në mjedis. Bile të tillë ka edhe në zonat e mbrojtura, si në Rugovë, Malet e Sharrit etj. Ndikimi në mjedis është i dukshëm sa herë që kaloni afër tyre: dëmtimi i peizazhit, dëmtimi i bimëve, ndotja e ajrit nga pluhurat, ndotja nga zhurma e cila ndikon në kafshët dhe gjallesat tjera që të ikën nga zona, ndikimi në ujërat nëntokësor dhe sipërfaqësor etj.

Shumë nga këta gurëthyes nuk i përmbahen as Vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM), për të cilën është i detyruar me ligj. Shumica prej tyre nuk e përdorin ujin për ndalimin e pluhurit i cili shkaktohet nga bluarja dhe bartja e materialit të bluar. Ky pluhur shpërndahet në mjedisin përreth duke mbuluar gjithë bimësinë dhe duke dëmtuar atë. Edhe më keq këtë pluhur e thithin qytetarët përreth ose kalimtarët e rastit.

Nuk ka ndonjë analizë, për secilin gurëthyes, për llojin dhe përbërjen e gurit, pluhurin e të cilit e thithin qytetarët. Afër disave prej këtyre jeta bëhet a padurueshme, si për njerëzit ashtu edhe për gjallesat tjera. Përveç pluhurit shkaktohet edhe zhurma, si ndotës, dëmtimi i rrugëve si dhe ikja e kafshëve të egra dhe i shpezëve. Gradualisht ato pjesë bëhen të vdekura.

- **Nxjerrja e zhavorrit, dëmtimi i ujërave lumor dhe i biodiversitetit ujor**

Veprimtari e ngjashme me gurëthyesit është edhe nxjerrja e zhavorrit, por me pasoja edhe më të rënda për mjedisin dhe për biodiversitetin ujor dhe tokësor. Sidomos kjo veprimtari zhvillohet në luginën përgjatë lumit Drini i Bardhë ku gjenden sasi të mëdha të zhavorrit dhe të rërës cilësore për ndërtim. Drini i Bardhë përshkon fusha shumë pjellore. Përfitimi nga nxjerrja e rërës dhe zhavorrit ka ndikuar në dëmtimin e shumë sipërfaqeve pjellore përreth lumenjve. Pasi që fitimet janë të mëdha nga shitja e rërës dhe çakllit nga gurëthyesit dëmtimi i tokave bujqësore thuaja është bërë i papërfillshëm nga qytetarët dhe institucionet. Sipërfaqe të tëra tani janë shndërruar në gropa me bimësi të ndryshme, ferra e shelgje.

Të gjithë operatorët e kësaj veprimtarie është dashur të marrin leje për shfrytëzim të këtij materiali me shumë përfitime. Të gjithë kanë bërë edhe vlerësimin e ndikimit në mjedis, por asnjëri prej tyre nuk i'u ka përmbajtur detyrimeve që ka marrë për shfrytëzim. Njëri prej detyrimeve në procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis është mos dëmtimi i botës bimore dhe shtazore në shtratin e lumit dhe përreth tij. Gjithashtu detyrim tjetër është rehabilitimi i hapësirës së dëmtuar. Por nëse kalohet përreth shihen vetëm gropa e djerrina të dëmtuara. Askush deri më tani nuk ka bërë ndonjë vlerësim të dëmeve në biodiversitetin ujor në ato vende.

Përveç dëmtimeve fizike të ujërave dhe të shtratit lumor në shumë raste është bërë edhe ndotje kimike nga rrjedhja e vajrave të makinave në ujërat e lumenjve. Nga kjo rrjedhje janë dëmtuar ujërat sipërfaqësor dhe nëntokësor. Derdhja e një litre vaji makine, i përpunuar, ndotë qindra litra ujë, njëkohësisht vret gjallesat në ujë.

Për shkak të cilësisë së rërës kjo veprimtari nuk po ndalet. Nuk ka as reagime të qytetarëve e as të shoqërisë civile, ose kanë qenë simbolike dhe pa efekte në uljen e nivelit të shfrytëzimit dhe të ndotjes, por edhe të dëmtimit të biodiversitetit ujor dhe jo vetëm. Mungesa e reagimit qytetar ndoshta mungon për shkak se një numër prej tyre edhe përfitojnë nga kjo veprimtari, qoftë duke lëshuar pronat për shfrytëzim, ose duke u punësuar në to. Por dëmet janë afatgjate.

Ende nuk dihet se sa janë pasojat për biodiversitetin ujor në lumenj. Makinaria që prish shtratin e lumit, dhe përreth tij, dëmton miliona gjallesa si dhe vezët e tyre. Prandaj, përveç dëmtimit fizik, dhe kimik nga vajrat e derdhur, ndikohet edhe në dëmtimin e pasardhësve të gjallesave duke u dëmtuar çerdhet dhe vezët e tyre. Ndërsa bimët e ndryshme shkatërrohen nga rrënjët dhe farat. Zhdukja e tyre është e sigurt.

- **Ofiçinat e ndryshme (autolarje, automekanike, përpunuesit e drurit, tekstilit..)**

Rajoni i Prizrenit është i njohur edhe për ekonomi të vogël, sidomos për zanate të ndryshme. Tani kohët e fundit iu kanë shtuar edhe një varg veprimtarish të cilat përveç përfitimit material kanë ndikim edhe në mjedisin përreth. Në shumicën e rasteve zhvillimi i këtyre veprimtarive është tejet i dëmshëm për ndonjërin nga resurset mjedisore për të cilat vepruesi nuk është në dijeni, ose nuk ka informata të mjaftueshme. Shkalla e rrezikshmërisë nga ndotja nga këto veprimtari varet nga lloji i tyre si dhe nga materialet që shfrytëzon gjatë ushtrimit të zanatit.

Ndër ato që llogariten me rrezikshmëri të lartë për mjedisin bëjnë pjesë, sidomos: ofiçinat e ndryshme mekanike, si: automekanikët (servisët) e ndryshëm, grumbulluesit dhe ricikluesit e metaleve, autolarjet, servisët e aparateve të amvisërisë dhe teknologjisë informative etj.

Autoservisët : janë shndërruar në veprimtari të shumta anë e kënd vendit. Ato gjenden qoftë në fshatra e qytete. Gjenden afër çdo rruge ku ka lëvizje makinash. Sot janë bërë të domosdoshme për shkak të numrit të madh të makinave të vjetra. Shumica prej tyre nuk iu përmbahen rregullave të mirëmbajtjes së punëtorive. Vajrat e përpunuar dhe bateritë e vjetruara/harxhuar janë ndotës të rrezikshëm nëse nuk menaxhohen sipas kërkesave dhe standardeve. Një pjesë e tyre vajrat e përpunuar i grumbullojnë në fuçi të veçanta pastaj ato shiten për ridestinim. Por disa prej tyre, sidomos disa që gjenden larg nga kontrollet dhe inspektimet, këto vajra i përdorin për djegie dhe ngrohje të ofiçinës. Një gjë e tillë është shumë e rrezikshme për mjedisin dhe për shëndetin e njeriut, por edhe e ndaluar me ligjin për materiet e rrezikshme. Djegia e tyre liron materie kancerogjene. Ato as nuk guxojnë të digjen e as të hidhen qoftë në tokë qoftë në ujëra.

Grumbulluesit e metaleve : Janë shndërruar në veprimtari shumë fitimprurëse. Mblidhen të gjitha metalet dhe pastaj shiten për skrap në shkretoret jashtë vendit. Vendgrumbullimi i tyre bëhet jashtë çdo standardi. Mjafton ta ketë një sipërfaqe toke dhe grumbullo aty. Me ligjin për mbeturinat janë përcaktuar kriteret dhe kushtet në të cilat lejohet grumbullimi dhe shitja e metaleve. Sigurimi i vendit/ truallit duke izoluar pengimin e depërtimit të materieve të dëmshme në ujërat nëntokësor, dhe vendosja jo afër rrugës ku qarkullojnë njerëzit dhe makinat (trafiku), por edhe kafshët janë kriteret që duhen respektuar. Të gjitha kriteret janë të përshkruara në dokumentin që quhet Vlerësimi i ndikimit në mjedis, të cilin duhet ta plotësojë, por edhe t'i përmbahet secili operues para se ta marrë lejen për zhvillimin e veprimtarisë.

Metalet kryesore që sot grumbullohen janë makinat e vjetra, ose të aksidentuara, pastaj pajisje të teknologjisë (kompjuter, televizor, video lojëra të ndryshme, pajisje shtëpiake (frigorifer, shporete, ngrohëse e ftohëse, etj.). Përbërja e të gjitha këtyre është nga metale të ndryshme, shpesh edhe metale të rënda, të cilat hyjnë në listën e mbeturinave të rrezikshme. Përveç metaleve shumë nga këto pajisje kanë edhe pjesë të tjera nga plastika, ose përmbajnë vajra të ndryshëm por edhe përbërës kimik të rrezikshëm, si acide etj., siç janë

makinat e vjetra, bateritë e makinave.

E keqja, dhe rreziqet nga këto mbeturina, është qëndrimi i gjatë si dhe ç'montimi i tyre pa kriteret për mbrojtjen e mjedisit. Ato i ekspozohen diellit dhe të reshurave atmosferike me javë e muaj derisa të barten në destinacionin e fundit. Nëpërmjet të reshurave, shiut sidomos, materiet e ndryshme kimike, si vajrat, acidet, ndryshku etj., depërtojnë nën dhe deri në ujërat nëntokësor. Edhe më keq kur ato barten në përroska dhe drejt lumenjve.

Në mesin e këtyre mbeturinave me rrezikshmëri të lartë bëjnë pjesë sidomos, bateritë e makinave të cilat grumbullohen për shkak të sasisë së plumbit që përmbajnë. Plumbi e kadmiumi janë metale të rënda dhe konsiderohen si mbeturina mjaft të rrezikshme për njeriun dhe mjedisin.

Autolarjet : konsiderohen si ndotës. Ato, sikurse autoservisët, kanë vërshuar në të gjitha anët. Nuk do të paraqisnin ndonjë problem, shqetësim mjedisor sikur t'u përmbaheshin rregullave për pastrimin e makinave, përdorimin e shampove të ndryshme dhe menaxhimin e ujërave të ndotur pas larjes së një makine. Pastrimi i makinave bartë me vete shumë ndotës, qoftë nga vet makina, qoftë të grumbulluara në sipërfaqen e saj, siç janë grimcat e ndryshme nga djegia e gazeve, pluhurat, si dhe vajrat e ndryshëm. Gjithashtu shampot e ndryshëm për pastrim paraqesin ndotje për ujërat në të cilët depërtojnë. Zakonisht ujërat e pista nga larja e makinës derdhen ose në rrjetin e kanalizimit ose në tokë. Kemi edhe shumë raste kur krahas larjes së jashtme të makinës këtu bëhet edhe pastrimi i motorit i cili ka sasi të shtrësuar të vajrave dhe lubrifikantëve të ndryshëm. Këto veç sa e shtojnë sasinë dhe shkallën e ndotjes.

Riciklimi i metaleve : riciklimi i metaleve kërkon kushte specifike. Ato shkrihen në temperatura shumë të larta, prandaj edhe kërkojnë burime energjie të kushtueshme. Zakonisht, bëhen përpjekje klandestine për riciklim të kanaçeve të aluminit si dhe baterive që përmbajnë plumb. Përveç materialeve për djegie, të cilat janë ndotës të ajrit, edhe lirimi i gazeve gjatë shkrirjes së këtyre metaleve paraqet rrezik për shëndetin e njeriut dhe për mjedisin. Për filtrat e gazeve as që mendohet në këto raste.

Përpunuesit e drurit : në viset ku ka male të larta, zakonisht është e zhvilluar edhe industria për përpunimin e drurit. Ky rajon është i njohur për këtë veprimtari. Përveç dëmtimit të pyjeve kjo veprimtari ka edhe efekte në mjedis. Gjatë prodhimit të produkteve nga druri përdoret edhe një varg bojërash e vernik për ruajtjen dhe zbukurimin e tyre. Të gjitha këto kanë përbërje kimike. Rrezik për mjedisin sidomos paraqesin mbetjet nga këto mjete kimike si dhe ambalazhi në të cilat ruhen ato. Ato hidhen në mbeturina ose në tokë. Gjatë zhbërjes së tyre lirohen përbërësit kimik të cilët paraqesin rrezik për botën bimore e shtazore të atij vendi. Edhe më keq kur pjesë e ambalazhit digjen duke liruar gaze të rrezikshëm.

Veprimtaritë tjera (zejët), si metalpunuesit, rrobaqepësit, përpunuesit e tekstileve, prodhuesit e gypave të plastikës, fermat e kafshëve, restorantet e ndryshme etj., në një mënyrë a një tjetër ushtrojnë ndikim në mjedis, ose në pjesë të tij me efekte negative në të.

Veprimtaritë e cekura nuk paraqesin ndonjë shqetësim mjedisor derisa ato nuk hidhen ose digjen. Për shembull, metalpunuesit përveç farkimit, saldimit, prerjes e gërryerjes a lëmimit të metaleve nuk kanë ndonjë efekt të dëmshëm. Por shpërndarje e grimcave nga prerja dhe lëmimi i tyre, pastaj përdorimi i ngjyrave të ndryshme për mbrojtje nga korrozioni, si p.sh., miniumi, shndërrohen në ndotës të dëmshëm për mjedisin dhe për shëndetin e njeriut.

Veprimtaria e një rrobaqepësi nuk përbën ndonjë shqetësim mjedisor përderisa nuk prodhon mbeturina nga tekstile të ndryshme. Sot një numër tekstilësh kanë prejardhje artificiale si dhe përdoren lloje të ndryshme ngjyrash me përbërje të ndryshme kimike. Hedhja ose djegia e tyre paraqet ndotës të dëmshëm. Një pjesë e zejtarëve gjatë sezonit dimëror të gjitha mbetjet i djegin për t'u ngrohur. Nga djegia e tekstileve lirohen gaze të dëmshëm pasi që përbërja e tyre, sidomos e ngjyrave është plotësisht kimike.

Fermat e shumta në këtë rajon: të gjedhit, deleve, pulave dhe derrave, përveç që shërbejnë për plotësimin e nevojave me produkte, por edhe për mbijetesë materiale, ato paraqesin edhe shqetësime të dukshme mjedisore. Mbajtja e kafshëve është e kamotshme, dhe e domosdoshme për mbijetesën e njeriut. Sot përveç mbijetesës është bërë veprimtari fitimprurëse, por edhe me ndikim të caktuar në mjedis. Kafshët janë prodhues të mëdhenj të dyoksidit të karbonit (CO₂). Gjithashtu plehu i tyre përmban sasi të konsiderueshme të kaliumit dhe të azotit sidomos. Jo të gjithë fermerët i menaxhojnë si duhet fermën dhe plehrat e tyre. Plehu përdoret për plehërimin e arave, por një sasi e lëngjeve fundërrinë nga zhbërja e plehut depërton në lumenj e përroska. Shtimi i sasisë së azotit në ujëra ndikon në shumimin e algave. (e kemi sqaruar më lartë këtë shqetësim për ujërat).

Përmendja e këtyre veprimtarive, si ndikues në mjedis, nuk bëhet me qëllim të mbylljes/ndaljes së tyre, por me qëllim të pasjes së informatave lidhur me ndikimin e mundshëm të këtyre veprimtarive në mjedis nëse ato nuk menaxhohen si duhet. Gjithashtu informata është e mirëseardhur për qytetarin nëse vëren se një gjë e tillë po ndodhë në mesin ku jeton.

- **Turizmi dhe shqetësimet/presionet mjedisore**

Zhvillimi i veprimtarisë turistike, sidomos turizmit malor, është i theksuar në rajonin e Prizrenit. Qëllimi i zhvillimit të turizmit është promovimi i vendit dhe ndikimi në zhvillimin e viseve malore. Në rajonin e Prizrenit, dhe Dukagjin, janë të njohura vendet, ose pikat turistike, si Prevalla, Brodi në Dragash, pastaj Bjeshkët e Nemuna, Radavci, Ujëvarat e Mirushes, Rugova, Vërmica etj. Në të gjitha këto vende, dhe të tjera, ka kushte të volitshme për zhvillimin e turizmit dhe të aktiviteteve të shumta atraktive, sportive dhe çlodhëse. Një pjesë e tyre janë nën mbrojtje, por edhe ka të tilla të cilat presin të vihen nën mbrojtje.

Veçantitë e vendeve të përmendura janë specifikat që ka secili prej tyre. Disa janë të pasura me bimësi, nganjëherë endemike, pjesa tjetër me kafshë të egra, si ariu, dhia e egër, rrëqebulli, apo edhe ndonjë tjetër atraksion, si burime uji, ujëvara, qendra për ski etj. Për shkak të këtyre veçantive edhe vizitohen nga një numër qytetarësh. Vetë prezenca e një numri të madh të qytetarëve në këto zona paraqet presion për mjedisin dhe biodiversitetin në këto anë. Nëse kësaj i shtohet edhe një numër i madh i veturave, atëherë presioni mbi mjedisin është i dyfishtë. Por, vizita për çfarëdo qëllimi në këto vende, lë pas vete edhe një varg vepimesh të pandërgjegjshme të vizitorëve. Këto veprime janë të llojllojshme, si: ndezja e zjarreve, hedhja e mbeturinave, dëmtimi i bimëve, shqetësimi i kafshëve dhe i gjallesave tjera e të ngjashme.

Pjesët e përmendura, disa me ligj të mbrojtura dhe të shpallura si park kombëtar, ose monumente natyre të mbrojtura, janë një pasuri e rrallë e cila mund të shfrytëzohet për qëllime arsimore, kreative dhe shkencore. Ato paraqesin një laborator të mirë për studime. Ato për momentin paraqesin vetëm një funksion, atë të turizmit dhe përfitimit nga restorantet e shumta.



fig.17 Brodi në Dragash



fig.18 Liqeni i Vërmicës

- **Çka të bëhet me mbeturinat**

Më lartë kemi cekur problemet me krijimin e mbeturinave, llojet e tyre dhe shqetësimet mjedisore që i shkaktjnë ato. Një numër i madh i qytetarëve nuk e kanë idenë se çfarë të bëjnë me mbeturinat e krijuara/prodhuara nga aktiviteti që ai e zhvillon. Për mungesë informatash, ende ka mendime se uji (lumi, përroska) është vendi për hedhjen e tyre. Dhe në shumë raste veprohet kështu: të gjitha llojet e mbeturinave hidhen në lumë. Edhe ky veprim është i ndaluar me ligj, por në ato vende ku nuk bëhet bartja dhe menaxhimi i mbetjeve, qytetarët bëjnë zgjidhje sipas rastit: grumbullim në deponi të egra, në pyje, në lumë ose i djegin.

Mungesa e informimit/vetëdijesimit lidhur me ndikimet e veprimtarisë në mjedis (mbeturinat, pesticidet, herbicidet, plehrat artificiale) sipas raportit të RIINVEST 2016, problem i përbashkët i shumicës së komunave të Kosovës është mungesa e kapaciteteve si dhe niveli i pamjaftueshëm i informimit dhe i ndërgjegjësimit për mbrojtjen mjedisit.

Veprimet e këtilla, përveç tjerash, bëhen edhe për mungesë të informatave lidhur me shqetësimet mjedisore që i shkaktjnë prezenca e mbeturinave në mjedis. Gjithashtu ka mungesë, dhe mangësi, në informimin dhe vetëdijesimin e të gjithë qytetarëve për pasojat që kanë mbeturinat për shëndetin dhe mirëqenien e tij. Ata mendojnë se me rëndësi është largimi i mbeturinave nga oborri, djegia e tyre ose çfarëdo forme e zhdukjes/largimit të tyre. Largimi i mbetjeve, sidomos atyre organike dhe të rrezikshme nga oborri, ose nga ofiçina, nuk do të thotë se ato nuk do të kthehen sërish në ndonjë formë më të rrezikshme. P.sh., nëse vajin e motorit e derdhim në tokë ose në lum a përroskë, ajo na kthehet në formë më të rrezikshme në ujin që ne e përdorim qoftë për pije ose për pastrim. Me këtë veprim shkatërrojmë botën e gjallë në lumenj, si p.sh. peshkun, me të cilin veprim ndikojmë në burimin e ushqimit shumë të vlefshëm. Hedhja e mbeturinave nga ushqimet në deponi të egra nuk do të thotë se e kemi zgjidhur problemin: pjesë nga ato mbetje do t'ua kthejnë në oborr kafshët endacake. Tani rrezikshmëria e tyre është edhe më e lartë pasi që ato bartin mikroorganizma të ndryshëm dhe të rrezikshëm për shëndetin e njeriut.

Ka mungesë informimi lidhur me rëndësinë dhe mundësinë e përdorimit të mbetjeve organike për plehërim–kompostimi. Sasi e madhe mbetjesh organike shpërndahen gjithandej. Një pjesë e tyre digjen duke menduar se kështu do të zgjidhet problemi i tyre.

Shumica prej këtyre mbetjeve mund të shfrytëzohen dhe të përdoren për qëllime plehërimi ose ripërdorimi. Procedurat janë shumë të thjeshta, po vlera e produktit është shumë e lartë. Mjafton të sigurojmë thasë plastmase, nga ato për mbeturina. Mbeturinat si ushqime, bimë, gjethe vendosen në to duke i përzier me një sasi dheu. Njomen me ujë dhe ajrosen herë pas here. Zhbërja e tyre shndërrohet në pleh organik shumë të rëndësishëm për ushqimin e bimëve.

Mundësi tjetër është punimi i arkave të veçanta për përgatitjen e kompostit nga mbeturinat organike. Procedurat janë të thjeshta: ndërtohet arka me dërrasa. Vendosja e mbeturinave bëhet në kate, shtresa, ku njëra shtresë duhet të jetë dheu. Njomen me ujë dhe mund të përzihen për t'i ajrosur.

Çfarë të bëhet me vajrat e përpunuar? Assesi nuk duhet hedhur! Ato duhet të mblidhen dhe të futen në enë të veçanta dhe të dërgohen për ripërpunim. Djegia nuk guxon të bëhet! Është e ndaluar me ligj, por edhe është në regjistrin e mbetjeve të rrezikshme. Djegia e vajrave liron materie shumë kancerogjene. Assesi të përdoren për ngrohje të lokaleve apo banesave.

Bateritë e makinave, pajisjet e teknologjisë, si kompjuter, televizor etj., assesi nuk duhet hedhur kudo, ose përpjekur për t'i shkrirë ato për përfitimin e metaleve si plumbi etj. Përbërja e tyre është me metale të rënda të cilat paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

REKOMANDIMET

Ndotësit e mjedisit janë vrasës të qetë (shpesh të fshehtë) të njeriut dhe të botës bimore e shtazore. Veprimi i tyre nuk shihet menjëherë, por reflektohet në mirëqenien e njeriut. Shumica nga ndotësit vjen nga aktiviteti i njeriut nëpërmjet mbeturinave të llojeve të përmendura. Këto shkaktojnë shqetësime mjedisore dhe shëndetësore. Dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin, sidomos biodiversitetin e vendit ku ndodhen. Dëmtimi i biodiversitetit, florës dhe të faunës, lë pasoja të pariparueshme për mjedisin. Në shumë raste kjo shkakton shkëputjen e zinxhirit ushqimor në natyrë prandaj edhe prishjen e balancës ekologjike të një mjedisi. Prandaj për ta parandaluar një dëmtim të tillë duhet ndërmarrë veprimet si në vijim:

- **Aktivitete vetëdijesimi/ informuese me qytetarët**

Të gjitha raportet flasin për prezencën e shqetësimeve mjedisore dhe të rrezikut nga ato. Gjithashtu flitet për mungesë ndërgjegjësimi dhe informimi të qytetarëve lidhur me pasojat nga shqetësimet mjedisore si dhe nga ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis, ose në resurse të veçanta mjedisore si: ujë, ajri, dheu apo biodiversiteti. Por ka mangësi edhe në informimin, sasinë dhe cilësinë e njohurive të qytetarëve se çfarë duhet të bëjnë në situata të caktuara, siç janë: menaxhimi i mbeturinave, ndikimi i veprimtarisë së tyre në mjedis, ndikimi i ndotjes në shëndetin e tyre, të drejtat e tyre për reagim dhe për informim, e drejta e tyre për t'iu drejtuar gjykatës në raste të caktuar të dëmtimit të mjedisit ose për ndonjë veprimtari ilegale etj.

Format dhe mjetet e informimit dhe të vetëdijesimit sot janë të shumta dhe të ndryshme. Mjetet e informimit, por edhe mediat sociale sot janë të qasshme nga shumica e qytetarëve. Në radiot dhe televizionet lokale, edhe nacionale pse jo, ka mundësi të mëdha, dhe duhet të organizohen programe të veçanta me porosi të veçanta se si duhet të veprohet në rastet e veçanta dhe cilat mund të jenë pasojat nga mosveprimi në këto raste.

Me rëndësi të veçantë është nëse këto informata ofrohen nga profesionistë të fushave të përkatëse në mënyrë që informatat të jenë të sakta dhe më bindëse për qytetarët. P.sh. një agronom i lavërtarisë mund të jap sqarime profesionale lidhur me rëndësinë e përdorimit të plehrave kimike dhe atyre organike. Një kimist do të sqarojë shkencërisht se cilat janë pasojat e përdorimit pa kriter të plehrave kimik, pesticideve dhe herbicideve të ndryshme për mbrojtjen e bimëve nga dëmtuesit. Një mjek mund të ofrojë informata profesionale lidhur me efektin e pesticideve etj., në shëndetin e njeriut, cilët janë treguesit nëse i ekspozohemi helmimit me këto preparate, si dhe për hapat që duhet të ndërmerim lidhur me këto veprime të dëmshme. Një qasje e këtillë mungon, ose shumë rrallë kemi ndonjë veprim të këtillë, ad hoc. Prandaj për përmbushjen e detyrimit qytetar dhe institucional për vetëdijesimin e qytetarëve duhet ndërmarrë hapat dhe veprimet si në vijim.

- **Programe të veçanta të trajnimit të bujqve për kompostimin, përdorimi i kimisë në bujqësi**

Bujku ynë, sidomos ata që kanë traditë të gjatë të ushtrimit të veprimtarisë agronomike, mendon se i dinë të gjitha çështjet që kanë të bëjmë me kultivimin e ndonjë kulture bujqësore. Ata mendojnë se është i rëndësishëm rendimenti, pasi që nga ai ka përfitimin, por jo edhe për mundësinë që ai duke shtuar rendimentin ndikon në mjedisin përreth.

Çështja e mbeturinave, dhe menaxhimi i tyre, paraqet problem më vete. Qytetari nuk ka informata të mjaftueshme se çfarë të bëjë me to, dhe si t'i shfrytëzojë ato për të mirën e vet dhe të mjedisit. Prandaj sot mbeturinat janë bërë burim i mirë për përfitim dhe në të njëjtën kohë mbrojmë mjedisin dhe shëndetin tonë. Prandaj është e domosdoshme jo vetëm informimi por edhe përgatitja e tyre për t'i shfrytëzuar ato, si: duke i kompostuar, ripërdor ose edhe riciklim. Nga mbeturinat sot krijohet edhe art, por edhe të mira të tjera materiale. Për këto duhet të hartohen programe të veçanta informimi, vetëdijesimi por edhe trajnimi.

- **Shtimi i aktiviteteve mësimore/edukative në shkollat e rajonit lidhur me efektet e aktiviteteve bujqësore dhe zejeve tjera në mjedis**

Secili rajon, komunë a fshat, i ka specifikat e veta, por edhe ushtron veprimtari të ndryshme në varësi me rrethanat mjedisore. Këto specifika janë një burim i mirë dhe mjet edukativ për nxënësit e atij lokaliteti. Në të gjitha veprimtaritë, zejet, që ushtron në fshat apo qytet, zhvillohen procese të ndryshme fizike, kimike, shoqërore etj., e të cilat mund të jenë subjekt i përshtatshëm mësimor. Me kurrikulën aktuale, shkolla dhe mësuesi kanë një autonomi të zgjeruar për përdorimin e mjeteve dhe të burimeve mësimore. Përveç tjerash, secila klasë është e obliguar që përveç mësimi të rregullt të ketë edhe mësim me zgjedhje. Organizimi i mësimi me zgjedhje bëhet me qëllim të plotësimit dhe të zgjerimit të njohurive nga fusha të veçanta të dijes. Prandaj vizita mësimore në vendin ku zhvillohen procese fizike, kimike, biologjike dhe shoqërore janë formë e pazëvendësueshme e formimit të brezit të ri. Po sipas kurrikulë së re, të bazuar në arritjen e kompetencave nga nxënësit, kryesore është arritje e rezultateve të nxënit.

Prandaj mjedisi, resurset mjedisore në mjedisin ku vepron shkolla, paraqet një rrethanë të pasur, laborator, për arritjen e rezultateve të të nxënësve, formimin e shkathtësive dhe vlerave të rëndësishme për përgatitjen e të nxënësve për jetë. Përgatitja për jetë nënkupton krijimin e rrethanave mjedisore të qëndrueshme edhe për brezat e ardhshëm.

Gjithashtu, shkolla nëpërmjet nxënësve mund, dhe duhet, të përçojë informata të rëndësishme në familje lidhur me veprimtaritë të cilat në ndonjë mënyrë dëmtojnë mjedisin dhe shëndetin e njeriut. Për shembull nxënësit në shkollë, në disa, kanë mundësi provash të lehta kimike, të cilat njohuri mund t'i bartin në familje sa i përket cilësisë së ujit, ndotësve, kursimit të ujit, menaxhimit të mbeturinave, treguesit e ndotjes etj. Me kurrikulin e ri një numër shkollash si lëndë me zgjedhje po përcaktohen për kursin Mbrojtja e mjedisit. Nëpërmjet kësaj lënde mund të ndihmojnë shumë edhe pasurimin e njohurive, por edhe ndërgjegjësimin e qytetarëve për shumë aspekte të ndikimit në mjedis, ose për zgjidhje të shqetësimeve mjedisore. Vizita në një baxho (qumështore) djathi ku zhvillohen një varg procesesh kimike dhe biologjike do të kishte efekt të dyanshëm: plotësimi i njohurive nga lëndët kimi e biologji, si dhe përcjellja e porosisë lidhur me efektet në mjedis që mund të jetë zhvillimi i një veprimtarie të këtillë.

Vizita në një oficinë mekanike, përveç përfitimit të njohurive për makinat dhe proceset mekanike, nxënësit mund të bartin njohuritë nga lënda kimi ose biologji për vajrat dhe ndikimi i tyre në mjedis, biodiversitet nëse ato nuk menaxhohen si duhet. Prandaj përfitimi është reciprok.

- **Shpërndarje e materialeve informuese / edukative për menaxhimin e mbeturinave, pasojat shëndetësore, rëndësinë e mbrojtjes së biodiversitetit etj.**

Informimi për të gjitha aspektet mjedisore të përmendura më lartë është shumë i rëndësishëm. Sot format dhe mundësitë e shpërndarjes së informatave janë të shumta. Institucionet dhe shoqëria civile, edhe nëpërmjet shkollave, mund të bëjnë punë të mëdha në informim. Është me rëndësi pasja e informatave të sakta si dhe grupi kujt i destinohen ato. Kur jemi te grupi i fokusuar, atëherë për secilin duhet të përzgjedhim informata, të dhëna për atë grupi. Për shembull nuk mund të iu ofrojmë të njëjtat informata nxënësve dhe bujqve, zëjtareve dhe bujqve. Prandaj të dhënat duhet të jenë me interes për grupin e synuar për ndryshim.

Format e mundshme për informim dhe vetëdijësim janë: materiale të shkruara, si: fletëpalosje, broshura, artikuj në gazeta e revista, tabela me porosi e të dhëna etj. Video materiale dhe audio materiale. Prezantime në punëtori e takime të veçanta me grupet e synuara. Debate në grupe dhe diskutime të tjera me publikun. Debate dhe diskutime duhet të organizohen për tema të veçanta dhe me rëndësi në të cilat duhet të merret edhe opinioni i qytetarëve për çështje të veçanta dhe të rëndësishme për qytetari dhe për mjedisin në përgjithësi. Me rëndësi të veçantë është që në këto debate e diskutime të marrin pjesë ekspert të fushës, të cilët kanë informata dhe përvojë në zgjidhjen e problemeve mjedisore dhe shoqërore.

EC është organizatë e komunitetit, e themeluar ne vitin 2006, që angazhohet për avansimin e demokracisë në nivel lokal në Kosovë. Organizata punon me një numër të konsiderueshëm grupesh të komunitetit, si dhe mirëmban një presion të përhershëm ndaj qeverive lokale për qeverisje gjithëpërfshirëse, transparente dhe llogaridhënëse.

EC angazhohet për qytetari aktive në formësimin e ambientit jetësor duke nxitur organizim të mirëfilltë të komunitetit, demokratizim të institucioneve dhe pasurim të jetës kulturore në qendrat kryesore të Kosovës, me fokus në Prizren dhe Prishtinë. Nga janari i vitit 2015, EC funksionon me këto tri programe: Qyteti Gjithëpërfshirës (mobilizim i komunitetit), Qeverisja e mirë (monitorim dhe avokim), Hulumtimi (prodhim i dijes).

EC angazhohet për qytete/komuna gjithëpërfshirëse në Kosovë. Organizata beson në vlerën e shtuar që sjell angazhimi i gjithësecilit në qeverisjen e qyteteve/komunave dhe në veçanti e atyre që kanë më pak qasje dhe mundësi për të ndikuar. Në punën e saj 13 vjeçare EC është fokusuar në mobilizimin e komunitetit duke u dhënë prioritet grupeve të nënpërfaqësuar. Ky angazhim e ka vendosur EC-in në krye të organizatave të komunitetit në Kosovë. Një nga metodologjitë dalluese të EC-it është ajo e planifikimit urban me pjesëmarrje, rezultatet e së cilës janë tejet të prekshme në komunën e Prizrenit.

Për shumë qytetarë të Prizrenit, por edhe për disa lokacione të tjera në Kosovë, EC shihet si adresë shumë kredibile për çuarjen tutje të nevojave, kërkesave dhe interesave komunitare. EC ka punuar dhe vazhdon të punëojë ngushtë me PAK, të moshuarit, gratë dhe vajzat, banorët e lagjeve informale, komunitetet joshumicë, artistët, ambientalistët dhe shumë të tjerë në baza ditore në përpjekjen e përbashkët për t'i kthyer nevojat e qytetarëve në vendime e veprime të institucioneve. Në të njëjtën kohë, EC ka ndërtuar grupe lokale të komunitetit në nivel të lagjes dhe fshatit në komunën e Prizrenit, ndërsa nga viti 2018 këtë praktikë po e bart edhe në komunat e tjera të Kosovës (deri në 2020 synohet zgjerimi deri në dhjetë komuna). Përveç angazhimit komunitar, EC njihet edhe për avokimin konsistent në mbrojtje të strukturës urbane të qyteteve të Kosovës, me fokus në vlerat e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Përmes rrjetit të gjerë të profesionistëve me të cilët bashkëpunon në baza të rregullta, EC ka zhvilluar standarde të larta të cilësisë sa i përket shërbimeve që i ofron dhe produkteve që i realizon. Organizata ka qenë dhe vazhdon të jetë kontribuese e drejtpërdrejtë e hartimit të një numri të konsiderueshëm politikash publike në nivel qendror dhe lokal. Në të njëjtën kohë, EC ka prezencë të shtuar edhe rajonale dhe ndërkombëtare përmes mekanizmave të rëndësishëm të rrjetëzimit profesional dhe të shoqërisë civile.